



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

FTESË PËR PJESËMARRJE NË FORUMIN RINOR NDËRKOMBËTAR NË EGJIPT

Zyra e Presidentit të Republikës Arabe të Egjiptit, në kuadër të Kongresit Kombëtar Rinor të Egjiptit, në datat 4-9 nëntor 2017 do të organizojë Forumin Rinor Ndërkombëtar në Sharm El-Sheikh, Egjipt. Forumi, i cili mbahet çdo vit në Egjipt, përbën një urë lidhëse mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera pjesëmarrëse dhe do të ofrojë një mundësi të shkëlqyer për të rinjtë, të cilët dëshirojnë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre mbi çështje botërore si:

- Rindërtimi i institucioneve shtetërore në zona në konflikt;
- Lehtësimi i kthimit të të rinjve për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm;
- Roli i rinisë në luftën kundër terrorizmit;
- Mënyrat për të luftuar rrënjët e migrimit të parregullt;
- Prezantimi i përvojës egjiptiane në pritjen e refugjatëve dhe integrimin e tyre social;
- Përgatitja e një strategjie ndërkombëtare për luftën kundër terrorizmit;
- E ardhmja e ndryshimeve klimatike;
- Civilizime dhe kultura të ndryshme;
- Konfliktet në Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore dhe ndikimi i tyre në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, etj.

Kandidatët e interesuar për pjesëmarrje në këtë veprimtari duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Të jenë veprimtarë nga organizata rinore dhe figura, punonjës të sektorit publik që kanë nivelin e duhur të njohurive për çështje rinore;
- Të kenë marrë pjesë edhe më parë në aktivitete të ngjashme për studentë ose aktivitete bamirësie;
- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Të kenë miratimin e institucionit publik/organizatës rinore për pjesëmarrje në këtë forum;
- Të jenë të moshës 18-45 vjeç.

Kandidatët, gjithashtu, duhet të dërgojnë **me postë brenda datës 30 shtator 2017** në Drejtorinë e Integritit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dokumentet e mëposhtme:

1. Një kopje të CV-së;
2. Letër mbështetëse nga institucioni publik/organizata rinore;
3. Certifikata te ndryshme për pjesëmarrje në aktivitete rinore;
4. Fotokopjen e faqes se pasaportës me të dhënat e identitetit;

Nënvizojmë se përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve për pjesëmarrje në këtë forum do të bëhet nga organizatorët e aktivitetit. Gjatë këtij procesi do të mbahet në konsideratë kriteri për barazinë gjinore.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE